



Pranuar më: Primlëno: 04.01.2024		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
05-453/01-841		

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIK OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 04.01.2024

Bazuar në Rregulloren e MF – NR-04 / 2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe vendimit Nr. 05-453/01-555 të datës 04.01.2024 për shpalljen e Thirrjes Publike për aplikim, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në zbatim të objektivës: Kulturore, Rinore dhe Rekreative me rastin e Pavarësisë së Kosovës.

1. Komuna e Lipjanit, gjegjësisht Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në përputhje me Planin vjetor të punës 2024 u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, që programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës, rinisë dhe sportit dhe rekreacionit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në këtë objektivë.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre në kuadër të objektivës kulturore me rastin e Pavarësisë së Kosovës, përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, rinore dhe rekreative.
3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **10,000.00** euro.
Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është **501,00** euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **10,000.00** euro.
4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën **26.01.2024**.
5. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në një (1) nga fushat prioritare sipas thirrjes.
Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike.

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e **Kulturore, Rinore dhe Rekreative**, përkatësisht të komponentës së pjesëmarrjes. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesve të mbështetjes financiare publike. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqes prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të pa-paguara, nëse është e aplikueshme.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (www.komunaelipjanit-ks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e më poshtme:

Komuna e Lipjanit
Rruga „Shqiperia” Lipjan
Zyra për shërbim me qytetaret nr.3
14000 Lipjan

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: pranvera.i.krasniqi@rks-gov.net.

Vërejtje : Shiko manualin e bashkangjitur dhe publikuar në web faqen e komunës

Anila Reçiça Llugiqi
Drejtoreshë e DKRS-së

